



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESEM 2022-2024 TË
BASHKISË SHKODËR ”.

Konsultim publik : *Banoret e Lagjes Nr.1*

Data : 26.10.2021

Ora : 13.00

Vendi: Salla e Këshillit Bashkiak

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesëmarrësve 34, nga të cilat 3 gra dhe vajza.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Per draft projekt planin buxhetor afatmesem 2022-2024 të bashkisë Shkodër*

Pjesëmarrës : Kryetari i Bashkisë znj.Voltana Ademi, zv. Kryetar i bashkisë z. Ardit Çylybyli, Kryetarja e Këshillit Bashkiak znj. Brisela Kadia, Kordinator për Njoftimin dhe Konsultimin me Publikun z. Fisnik Lutfija, Drejtor i Drejtorise Ekonomike të Arsimit Zj.Aulida Anamali, si dhe përfaqësues te drejtorive përkatwse të bashkisë Shkodër.

Takimi bashkë-drejtohet nga Kryetare e bashkisë Znj. Voltana Ademi dhe Kryetare e Këshillit Bashkiak të cilat bëjnë një prezantim të shkurtër në lidhje me:

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjeguan qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtuan pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Udhëzuan për mënyrën e organizimit dhe mbarëvajtjes së takimit, me qëllim arritjen në përfundime dhe rekomandime konkrete për përmirësim.
- ✦ Koordinuan diskutimin ndërmjet pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

I: ARSIMI PARASHKOLLOR, BAZE, i MESEM i PERGJITHSHEM, PROFESIONAL

1. Z.Fatmir Perseku, banor i lagjes Shirokë.

a. Përsa i përket shkollës në Shirokë. Shkolla nuk ka kushte, nuk ka derë oborri, tarraca pikon, sovatomet që janë bërë nuk kanë cilësinë e duhur, nuk ka kënd lojrash për fëmijë.

2. Z. Andi Kadija, punonjës pranë Bashkisë

3. Shkolla Ndre Mjeda ka dy probleme:

- Problem është oborri i shkollës sepse në ditë me shi, fëmijët e kanë të pamundur për të hyrë në shkollë.
- Gjatë komunikimit me drejtuesit e shkollës, janë shprehur për mungesën e ambjenteve mësimore dhe konkretisht kërkojë
 1. Shtimin e ambjenteve të shkollës
 2. Ndërtimin e një këndi lojrash për fëmijë

4. Z. Elvin Hoxha

- a. Tek trotuari në afërsi të shkollës Ndre Mjeda është një kioskë, e cila duhet hequr sepse pengon kalimin e fëmijëve.
- b. Po tek kjo shkollë është edhe një oficinë që ka frekuentim të madh automjetesh. Është e rrezikshme për fëmijët prezenca e makinave në këtë zonë. Është e mirë që te vendoset një sinjalistikë që makinat të mos parkohen në këtë zonë.

II: MENAXHIMI I MBETJEVE

1. Znj. Vildana Gushta, banore e lagjes Nr.1

- a. Numri i banorëve në lagje është i konsiderueshëm. Bëhet punë vazhdimish për pastrimin e mbetjeve, por ka problematike në zonen e unazës. Kontinjerët nganjeherë tejmbushen.
- b. Rruga Hasan Podgorica ka nevojë që të shtohen kontinjerë dhe të rriten frekuenca.

2. Znj. Dhurata Tyli, anëtare e këshillit Bashkik

- a. Në mbledhjen e fundit të këshillit bashkiak, trajtova shqetësimin e mbetjeve pas urës së Bunës. Bashkia u vu në lëvizje, dhe u realizu shërbimi i pastrimit në këtë zonë. Doja të bëja një thirrje sensibilizuese që të mbajmë pastër ambientin.

3. Z. Ded Prendi, banorë në Liovadhe Zooteknike

- a. Në zonen tonë kemi nevojë për shtim pikash grubullimi mbetjesh dhe kontinjerë.

4. Z. Fatmir Perseku

- a. Pastrimi i kontinjerëve bëhet rregullisht. Ne kemi problem me vëndqëndrimin e kontinjerëve në qendër të Shirokës. Kontinjerët kanë zënë shetitoren.
- b. Problem tjetër është pika e grumbullimit të mbetjeve tek rruga në drejtim të Zogaj. Kjo pikë duhet të zhvendoset.

5. Z.Andi Kadija

- a. Në Shirokë nuk kemi ndonjë problematikë. Në 150m rrugë janë të vendosura 3 pika grumbullimi mbetjesh, një në hyrje te Shirokës, një në qendër, një në dalje. Me sa jam unë në dijeni nuk kemi pasur ndonjë ankesë.
- b. Problematikë kanë qënë lokalet simjet. Sepse bëhet hellja e mbeturinave në orare të ndryshme dhe kontinjerët mbushen përnjëherë.

1. Znj.Voltana Ademi

- c. Propozoj që secilit biznes t'ia çojmë nga një konteiner në vendin e ushtrimit të veprimtarisë, dhe familjeve t'ia dërgojmë konteinerwt në lagje, Kjo është një mënyrë pwr tw hequr tw gjithë konteinerwt përgjatë rrugës së Shirokës.
Si mendoni a është një mendim që na shërben?

2. Z.Andi Kadija: Kjo do të ishte një zgjidhje shumë e mirë sepse ndotësit më të medhenj janë klubet.

3. Z.Shaban Jacaj, banor në Zootechnikë, Rruga Çun Mula.

- a. Kemi problem me rrugen “Çun Mula”, e cila është shumë e ngushtë. Kjo rrugë ka nevojë të rregullohet pasi është bërë me gropa të mëdha, dhe kanalizime ska.
- b. Gjithashtu problematikë tjetër është ndriçimi. Do ju kërkoja që kjo rrugë të merrët ne konsideratë.

4. Znj. Vildana Gushta

- a. Përsa i përket pastrimit, problematike tjetër është rruga e Udhakryqit, dhe rruga tek Qendra Shëndetësore. Kontinjerë ka, por duhet të shtohet frekuenca e pastrimit.

5. Znj. Voltana Ademi: “Mendoj që duhet bërë shpërndarje të konteinerwve në brëndësi të lagjeve. Sepse të shtohen konteiner në një pikë të vetme, kjo nuk shwrben pwr pwr mirwsimine shwrbimit.

6. Z. Andi Kadija

- a. Propozoj që të vendosen 2 kontinjerë tek JUMBO tek prokuroria, dhe të vendosen kontinjerë tek Shpari dhe tek Big marketi.

7. Znj.Vildana Gushta

- a. Mendoj që do të ishte e mirë që çdo biznesi ti caktohen kontinjerë.

8. Z.Gjeto Lisi, banor në Zootechnikë, rruga Çun Mula

- b. Rruga jonë nuk pastrohet. Ka mungesë kontinjerësh. Mendoj që kjo rrugë ka nevojë për 8 kontinjerë. Gjithashtu kjo rrugë nuk ka ndriçim. Tek kjo rrugë jetojnë 35 familje. Të shikohet mundësia e investimit në këtë rrugë.

III: NDRICIMI RRUGOR

1. Z. Dedë Prendi

- a. Kërkoj që të vendoset ndriçimi rrugor tek Rr.Danjel Muzali

2. Z. Zamir Bega, banor i lagjes Dudas

- a. Në unazen perendimore ndriçimi është i mirë por pengohet nga pemët. Kërkoj që të bëhet krasitja e pemve në këtë zonë.

3. Qytetari, banorë në Zooteknikë

- a. Kërkoj që në rrugën Selim Çoba të investohet për vendosjen e ndriçimit, është një zonë që nuk ka ndriçim.

IV: GJELBERIMI

1. Znj.Diana Muriqi, antare e Këshillit Bashkiak

Përsa i përket gjelbërimit. propozoj që të priten pemët në rrugën në fund të Xhabijes sepse janë rritur jashtzakonisht shumë, dhe pengojnë lëvizshmërinë e këmbësoreve dhe të automjeteve. Të shikohet me vëmendje prerja e pemëve në këtë aks rrugor sepse është rrugë me rrezikshmëri të madhe.

V: RRJETI RRUGOR

1. Qytetari:

- a. Rrugët “Çun Mula”, “Selim Çoba”, “Selim Gjyrezi” janë rrugë të amortizuara dhe kanë nevojë që të shtrohen.

2. Z.Fatmir Vrina, banor i lagjes Guarrile

- a. Kërkoj që të shtrohet rruga Karvanej pasi është tejet e amortizuar.

3. Z.Gentian Smajli, banorë në rrugën Has Hoxha.

- a. Rrugica është në gjendje shume të amortizuar, dhe ka nevojë që të shtrohet.Jetojnë rreth 70 banore tek kjo rrugice dhe është 180m e gjatë.

4. Z. Bekteshi:

- a. Ju falenderoj që keni ndërtuar këtë linjë komunikimi me qytetarët. Unë banoj tek rruga “Kongresi i Manastirit”. Jemi 7 familje, është edhe një ndërtim ne process, mund të arrijmë 10 familje. Kjo rruga ka nevojë të shtrohet (30 m gjatësija e rrugës)
- b. Zona e peshkut në Zdrale ka një trafik të jashtzakonshem. Ka nevojë për viza të bardha.

- c. Duhet të shihet mundësia e lirimit të trotuareve. Nga Zdralja në drejtim të stadiumi zaptohen trotuaret nga bizneset. Njerëzit detyrohen të ecin në rrugë, dhe bëhet burim aksidenti. Në këto raste duhet të vepohet me force për lirimin e haprave Publike (trotuare).

5. Z.Denis Çela, banor lagjes Adem Haxhia

- a. Rrugica Hotnej është tejet e amortizuar, dhe në periudhen e dimirit bëhet e pakalueshme (rruga ka gjatësi 800m).Tës hsikohet mundësia e investimit në këtë rrugicë.

6. Abdyl Mersini Rr. Osja e Falltores

- a. Kam një shqetësim për një pjesë rruge që duhet asfaltuar. Ne jemi më lart se Euro Drini por sa herë që bie shi ne përmytlemi. Behet fjalë blloku tek Çelepjet (30-50 m gjatësia e rrugës).

7. Z.Erjon Tevija, L. Salo Halili, Tophane:

- b. Kemi problem me një rrugicë të vogël, tek rrugica në afërsi të zukthave. Është një rrugicë që nuk ka kanalizimet e ujra të bardha dhe të zeza, dhe ka nevoj që të shtrohet. Kjo rrugicë lidh 2 pallate dhe disa shtëpi private. Të shikohet me përparësi mundësia e ndërhyerjes tek kjo rrugicë sepse qarkullojnë një numër i madh banorësh (80 m është gjatësia e rrugës).

8. Z. Gentian Bekteshi, banor i Rrugës Myzafer Pipa

- a. Kërkoj që të shtrohet rrugica e Garucve pasi është shumë e amortizuar. Tek kjo rrugicë banojnë 30 familje. Kemi bërë dy herë kërkesë, dhe e kemi shoqëruar dhe me foto. Kjo rrugicë nuk ka as kanalizime.
- b. Problem tjetër është vendosja e bumeve tek rruga nga Çinari deri në Zdrale, si dhe tek shkolla e Gjuheve te Huaja sepse makinat ecin me shpejtësi.

9. Z.Qemal Elezi, banor i rr. Udhakryq

- c. Rruga jonë është shumë e amortizuar (rruga Jul Bariboba që të lidh me bypasin). Ne jemi një lagje shumë e populluar . E kemi të vështirë që ti çojmë fëmijët në shkollë.Ndriçim nuk kemi. (600-700m është gjatësia e rrugës).

10. Znj.Dhurata Tyli, anëtare e Këshillit Bashkiak.

- d. Kam bërë një takim me banorët e lagjes Bahcallek. Shqetësimet i kanë fillesat që në kohën kur është ndërtuar rruga e re. Janë mbyllur pesë ura për shkarkimin e Drinit.
- e. Ka shumë avulli që duhen prishur, gjë që do të ndikonte në shkarkimin e ujerave të rrugës drejt Drinit. Ura e vjetër është blloku pa leje nga një biznes. Janë bllokuar pesë rrugë, cfare e bën të pa mundur shkuarjen e njerezve për tu larë në breg të lumit Drin. Prita në fund të

rrugës nuk është funksionale. Janë rreth 18 familje të lagjes bahcallek që më kanë percjellur këtë shqetësim.

11. Z. Fatmir Perseku, banor në Shirokë

- f. Rruga nga varrezat deri sipër duhet rregulluar sepse jetojnë rreth 18 familje.
- g. Rruga nga Kampi deri tek Xhamija është e amortizuar dhe duhet të afaltohet.

12. Qytetari

- a. Të vlerësohet mundësia e vendosjes të një bumi tek Xhamija e Kirasit sepse aty afër është shkolla Azem Hajdari. Është rrugë më kalushmëri të lartë automjetesh, dhe është burim aksidentesh.

13. Znj.Vildana Gushta

- a. Rruga Xhemal Naipi, ka nevojë për investim sepse është në gjëndjë të amortizuar.
- b. Rruga Fadil Podgorica, ka nevojë për investim sepse është në gjëndjë të amortizuar.
- c. Rrugët lidhëse Haxhi Lohja - Fadil Podgorica - Ethem Kazazi, kanë nevojë për investim sepse janë në gjëndjë të amortizuar.

14. Elidon Dervishi, përfaqësues i transportit urban

- a. Aksi Xhabije – Parrucë ka shumë ngarkesë në trafik. Këtu qarkullojnë një numër i madh automjetesh. Kërkoj që të shikohet mundësia që rruga të bëhet me një sens kalimi.
- b. Menaxhimi i mbetjeve nga bulevardi Parrucë – Xhabije : Të shikohet mundësia e vendosjes së koshave të vegjël në të dy krahët e rrugëve për të mbuluar nevojat e mbetjeve për qytetarët.

15. Z.Illir Mani, operatori i linjes Shirok - Zogaj

- a. Rruga nga klubi Blu Note deri në Zogaj është e vështirë për tu kaluar sepse është një rrugë e ngushtë. Të shikohet mundësia e zgjerimit të kësaj rruge.

16. Znj.Diana Muriqi

- b. Tek lagja Nr.4, rruga e ish Dekorit është tejte e amortizuar dhe pa ndriçim. Kërkoj që të merret në konsideratë investimi në këtë rrugë.

17. Z.Andi Kadija

- a. Rrugica “Kraje” ka nevojë që të shtrohet.

18. Z. Erjon Dervishi, përfaqësues i transportit urban

- a. Të shikohet modeli i parkingjeve me pagesë në të dy anet e rrugës në qendër të qytetit.

19. Z.Andi Kadia

a. Tek lulishtja në Zdrale banorët kërkojnë vendosjen e stolave dhe sinjalistikës.

Pyetje e diskutime të tjera nuk ka. Mbledhja deklarohet e mbyllur.

Mbajtësi i procesverbalit

Fisnik Lutfija







BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun - Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2022-2024
LAGJIA NR.1

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
1	Demak	Elegi	Meshkullor	69	Udhëheqja		artpensioner
2	Arabi	KABAJA	M	49	L.1	IPS sektori	
3	Engjuz	Behtshin	M	33	L.1	Vetpensioner	
4	Gurhan	Kollachi	M	30	L.1	Udhëheqja	
5	Selimi	Polloni	M	42	L.1	JURIST	BASHKIA SHKODËR
6	Vilhoq	Çunata	F	53	L.1	Jurist	ZGJÇ
7	Besari	Gurshin	M	36	L.1	Ekonomist	Ekonomist
8	Fatmir	Muga	M.	56	L.1	Vetpensioner	Vetpensioner
9	Erjan	Terija	M	39	L.1	Ekonomist	Driftor Driftori OSHKSA Shkodër
10	Miri	Karri	M	49	Personali		
11	Melidon	Derishi	M	27	L.1	Transport udhëh.	Vetpensioner
12	Edri	KAZAZI	M	34	PERSONALI	Ekonomist	TS Sh.9
13	Enpa	Gusha	M	23	Xhobije		

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK



Këshillim me publikun - Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2022-2024
LAGJIA NR.1

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
14	Melvin	Hedilaj	M	34	SHKODËR	JURIST	PRIVAT
15	FATBARDH	GLISHIA	M	50	SHKODËR	PUNTOR	BASHKI
16	STIVEN	GUSHA	M	27	SHKODËR		NET PUNESUAR
17	FATMIR	PERSEKIU	M	48	SHIRAKU	J.P.B.SHKODËR	BASHKI
18	Shindito	Riçe	F	41	Shkodër	Mesues	Administratë
19	Humata	Tyri	F	67	Shkodër	Pensivist	—
20	Contiom	Smajk	M	47	Shkodër	Puntor	Privat
21	Zonhar	Beq	M	46	Shkodër	Puntor	Privat
22	Fatma	Karva	M	75	Shkodër	Pensivist	—
23	Jamuz	Guamam	M	35	SHKODËR	PUNTOR	BASHKI
24	Demis	Cela	M	25	Shkodër	Dj	—
25	Bleta	Tipi	M	53	Shkodër	Shkrimtar	—
26	Ujic	Bozovic	M	72	Guamile	Shkrimtar	—

COORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK



Këshillim me publikun - Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2022-2024
LAGJIA NR.1

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
27	Halil Bajgor	Halil		41	Lejgjer	Lejgjer	
28	Desha	Desha	M	62	desha	Shkolltar	Shkolltar
29	Hadir	Hadir	M	53	Shkodra	Shkolltar	10 shkolltar
30	Arman	Arman	M	66	Shkodra	Shkolltar	175 SHK.A
31	Edvin	Hoxha	M	47	Shkodra	JURIST	RTF
32	Artaquni	Artaquni	M	57	Shkodra	Profesor	TS SHK.A
33	Fatmiri	Fatmiri	M	42	SHKODRA	IPA	PUN
34	Aschyl	Aschyl	M	58	Shkodra	Shkolltar	D.V. IC M. R. G. G.

COORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK